



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

P. nr.127/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Rrahman Beqiri, me procesmbajtëse Selvije Kostërçi, në lëndën penale ndaj të pandehurit B.N nga ..., për shkak të veprës penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 275 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje: KPRK), duke vendosur sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.4553/2018 të datës 01.02.2019, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me dt. 15.05.2019 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Shpetim Peci dhe të pandehurit, me datë 15.05.2019 publikisht shpalli, ndërsa me datë 05.06.2019 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B.N, nga i ati S. dhe e ëma S., e vajzërisë R., i lindur me datë ... në ..., ku edhe jeton Rr. “...” pnr., i martuar, baba i një fëmije, ka të përfunduar shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike, me nr. personal ... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORË

Sepse,

Më datën 04.09.2018, në qytet pikërisht në rrugën “...” në ..., pa autorizim ka poseduar narkotike, në atë mënyrë që policia e Kosovës gjatë një kontrolli rutine kanë ndaluar tani të pandehurin B.N i cili ishte futur në një skutë tek një parking i veturave dhe tentonte që ta mbështjellte një cigare të dyshuar me substancë narkotike të llojit marihuan, policia gjatë kontrollit në xhepin e djathtë të pantallonave ka gjetur dhe ka konfiskuar një qese me substancë narkotike e llojit marihuane, që përmban tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto 0.72 gram.

Me këtë ka kryer veprën penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 275 par. 1 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 45, 46, 69, e 73, të KPRK-se, dhe nenit 365, 450, 463 të KPP-së, e:

G J Y K O N

1. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
2. Dënim me gjobë në shumë prej 450€ (katërqind e pesëdhjetë euro) të cilën shumë obligohet ta paguaj brenda afatit prej tre (3) muajve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në tre këste të barabarta. Në rast se i pandehuri nuk e paguan gjobën, atëherë kjo shumë e dënimit me gjobë mund t'i shndërrohet menjëherë në dënim me burgim sipas ligjit.

3. Në mbështetje të nenit 275 par.3 e lidhur me nenin 69 të KPRK-së dhe nenin 282 par.2 nenpar.2.4 të KPP-se, të pandehurit i shqiptohet edhe: Dënim plotësues - konfiskimi i sendeve dhe atë:
 - a. substanca narkotike e cila përmban Tetrahidrokanabinol (THC), me pesha 0.72 gram.
4. Obligohet i pandehuri, që t'i paguajë shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, ndërsa në emër të paushallit gjyqësorë të paguaj shumën prej 20€, në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.4553/2018 të datës 01.02.2019, kundër të pandehurit B.N nga ..., për shkak të veprës penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 275 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar ashtu që në këtë seancë i pandehuri e ka pranuar fajësinë në tërësi sipas aktakuzës, duke theksuar se e ndjej veten fajtor për veprën penale që i vihet në barrë si dhe ka shprehur keqardhje për atë që ka ndodhur, dhe se i ka premtuar gjykatës që nuk do të përsëris veprimet e tilla në të ardhmen.

Prokurori, lidhur me pranimin e fajësisë ka dhënë mendimin se i pandehuri e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, ky pranim është në pajtim edhe me provat materiale, gjendjen faktike dhe kualifikimin ligjor të veprës penale, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për pranimin e fajësisë, pas njoftimit paraprakisht nga ana e gjykatës për favoret dhe disfavoret që kanë të bëjnë me pranimin apo mospranimin e fajësisë, andaj i propozon gjykatës që ta pranojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri, e në mbështetje të nenit 248 të KPP-ës, në këtë drejtim vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë për të pandehurin. Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, mbështetet në provat me të cilat disponon kjo gjykate si: Raporti i policit nga vendi i ngjarjes i datës 04.09.2018; Raporti i ekspertimit të datës 26.10.2018; Deklarata e të pandehurit dhënë në polici e datës 04.09.2018; Memorandumi zyrtar i datës 04.09.2018; Foto dokumentacioni. Të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë elementin inkriminues e që në bazë e tyre dhe pranimit të fajësisë, konsiderojmë se për tej çdo dyshimi është vërtetuar se i pandehuri, ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Gjykata, ka vërtetuar se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në mënyrë vullnetare, se i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, duke i'u tërhequr vërejtja të pandehurit se pas pranimit të fajësisë, ai nuk mund të bëjë ankesë për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, por vetëm sa i përket llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata ka vërtetuar se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik, nga këto arsye gjykata e ka aprovuar pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat e cekura si më lart, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se i pandehuri ka kryer veprën penale: Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge neni 275 par. 1 të KPRK, e për të cilën vepër penale është paraparë dënimi me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet.

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit ne mbështetje të nenit 73 të KPP-ës. Si rrethana rënduese ka gjetur shkallen e përgjegjësisë penale gjë që nga provat rezulton se i pandehuri

këtë vepër e kishte kryer me dashje, faktin se këto vepra penale janë rritje e sipër, sidhe faktin se edhe më parë ka qenë i dënuar për vepër penale, fakt ky që vërtetohet nga vetë deklarimi i i të pandehurit përpara gjykatës.

Ndërsa, si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale, faktin se i njëjti ka shprehe keqardhje dhe është penduar për ndodhjen e rastit, sjellja korrekte e të pandehurit në gjykatë.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, shqiptimi i dënimit me gjobë dhe me burgim, ndaj të pandehurit është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Poashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 par 1 të KPRK-së, që ti parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata, si në diapozitiv të Aktgjykimit ndaj të pandehurit, ka shqiptuar edhe dënimin plotësues – marrjen e sendit, respektivisht konfiskimin e substancës narkotike, duke marrë për baze sigurinë juridike po ashtu të njëjtat janë sende që është rezultat i kryerjes së veprës penale siç vërtetohet më lartë, në mbështetje të nenit 282 par.1 e lidhur me par.2 nenpar.2.4 të KPP, ku përcakton se kimikatet, fabrikat, pajisjet laboratorike apo substancat e krijuara apo të përdorura në veprën penale nga nenet 272 deri 280 të KPRK, pasuria që është qenësisht e paligjshme i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pa marr parasysh gjetjet e gjyqtarit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e të pandehurit, e lidhur me nenin 69 i KPRK-së, i cili përcakton se sendet e përdorura apo të destinuara për kryerjen e veprës penale apo sendet të cilat janë rezultat i kryerjes së veprës penale do të konfiskohen, andaj për shkak të këtyre konstatimeve gjykata ka vendosur si në dispozitiv për konfiskimin e tyre.

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e paushallit gjyqësor. Ndërsa taksa për kompensim viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05\L-036 per Kompensimin e Viktimave të Krimit

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 365, 450, 453 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.127/2019, dt.05.06.2019

Procesmbajtësja:
Selvije Kostërci

Gjyqtari

Rahman BEQIRI

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit Prishtinë, në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.